



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 7084/2025

A.nr.1043/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shaban, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1043/2025, të datës 02.06.2025, të parashtruar nga ankuesja, E.R-H kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1043/2025, e datës 02.06.2025, e parashtruar nga ankuesja, E.R- H.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 05.05.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me shpalljen e kandidatit fituese në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00016376.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, E.R-H(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 02.06.2025, përmes e-mailit zyrtar *ankesa.kpmshck@rks-gov.net*, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016376, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita e punës *Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave, Kimikateve dhe Materialeve të Rrezikshme*, të shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3695/2025, të datës 02.06.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 02.06.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 16.06.2025, së bashku me të gjitha dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00016376, të datës 20.01.2025; Ri-njoftimin e datës 25.03.2025; Rezultatet e vlerësimit, të datës 05.05.2025; Vendimi për shtyrje të procedurës së verifikimit të datës 06.03.2025; Njoftimi për kandidatin fitues, të datës 05.05.2025; Njoftimin me E-mail të datës 05.05.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Pyetjet në intervistë me gojë të datës 18.04.2025; Formulari i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë, të datës 18.04.2025; Njoftimin e datës 18.04.2025; Testi individual i ankuseses i datës 02.04.2025; Testi individual i kandidatit fitues i datës 02.04.2025; Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit, i datës 07.04.2025; Pyetjet e hapura për testin individual; Njoftimin e datës 18.04.2025; Vendimin e datës 03.11.2022; Akt emërimit të datës 01.07.2025; Akt emërimit të datës 13.05.2015, më numër të vendimit 2129/AMMK/2015; Vendimin e datës 01.12.2023; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit të datës 20.06.2018; Akt Emërimit, e datës 02.08.2024; Akt Emërimit të datës 19.05.2014; Akt Emërimit të datës 06.06.2015; Vendimin për formimin e komisionit me numër 14/AMMK/2025, të datës 24.03.2025; Njoftimin e datës 22.03.2025; Lista e aplikantëve (aprovuar dhe refuzuar); Njoftimin e datës 24.03.2025; Njoftimin e datës 20.03.2025; Lista e kandidatëve në pritje; Kërkesën për publikim të konkursit, të datës 20.01.2025; Formularin e përshkrimit të punës; Aplikacionin me datë aplikimi, 19.02.2025 të kandidatit fituese, A.Z, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 18.02.2025, të ankuseses E.R.H, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin me numër protokolli 4766/2025 i Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 20.10.2025, ka shpallur konkursin me nr.ref: RN00016376, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Vlerësim të Gjendjes së Mbeturinave, Kimikateve dhe Materialeve të Rrezikshme”, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, me klasë të pozitës Profesional 2, një (1) vend pune, i hapur për aplikim nga data 21.01.2025 deri më datën 19.02.2025.

-Ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, duke kaluar fazën e verifikimit paraprak si kandidat që ka plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, e njëjta i është nënshtruar edhe fazave të vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arrit 54 pikë, ndërsa, në intervistën me gojë 24.2 pikë, në total ankuesja ka grumbulluar 73.1 pikë.

-Divizioni i Burimeve Njerëzore në MMPHI, më datë 05.05.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se si kandidate fituese për pozitën përkatëse është shpallur A.Z me 85 pikë.

Pas publikimit të Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor se e njëjta i plotëson të gjitha kriteret për pranim në shërbim civil, pasi që, ankuesja posedon diplomën e studimeve themelore dhe master të cilat përshtatet me pozitën përkatëse, dhe mbi këto fakte ankuesja duhej të ishte kandidate fituese. Shton së nuk i është bërë vlerësim i drejtë tek eseja në testin me shkrim si dhe në intervistë me gojë. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe ta anuloj njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues dhe ankueses ta jep të drejtën për emërim në këtë pozitë.

Kolegji i Këshilli në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimi me Nr.ref: RN00016376 dhe si rrjedhojë Kolegji nuk ka arritur të evidentoj shkelje esenciale ligjore e të cilat si të tilla do ta cenonin vlefshmërinë ligjore të kësaj procedure. Në këtë kontekst, fillimisht, Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me referencë RN00016376 ku dhe vërtetohet së si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën përkatëse janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor):* Inxhinieri, Mjedis, Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji, Gjeografi; **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i`u referuar dispozitave të nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive*

profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”

Po ashtu, për vendosje të drejtë dhe meritorë lidhur me çështjen Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë: **-Nenin 8:** [Vlerësimi profesional]: Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.

-Nenin 9: [Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim]: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 7/22 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenin 10: [Vlerësimi nëpërmjet intervistës] 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 8/22 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë.

Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së kriteret e përgjithshme për pozitën e shpallur kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil (kodi SHC-1498). Konkursi është shpallur nga njësia përgjegjëse, pasi që bazuar në Rregulloren në fuqi Nr. 05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit, si agjenci ekzekutive në kuadër të MMPHI-së nuk ka në strukturë të saj organizative njësinë e burimeve njerëzore, andaj, shpallja e konkursit nga njësia e Burimeve Njerëzore të MMPHI-së konsiderohet veprim i drejtë dhe i ligjshëm sipas nenit 26 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L -113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Komisioni i Pranimi i themeluar sipas Vendimit Nr. prot:1765, të datës 24.03.2025, të Sekretares së Përgjithshme të Drejtorit Ekzekutiv të AMMK-së, ka qenë në pajtim më kërkesat ligjore sipas nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë.

Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore për vlerësim jo të drejtë në testin më shkrim dhe intervistën më gojë, Kolegji ka gjetur se procedura e testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht testi ka përmbytur 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja. Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të aplikuar në procedurën e kontestuar Kolegji nuk vëren të meta në vlerësimin e drejtë të ankueses lidhur me testin më shkrim, pasi që ankuesi ka dhënë 20 përgjigje, të sakta duke arritur 40 pikë, si vlerësim që behët nga sistemi, ndërsa, në vlerësimin e esesës si vlerësim diskrecional nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me 14 pikë, nga 20 pikët maksimale, duke arritur gjithsej 54 pikë, kështu që, pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Po në kuptim të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, Kolegji ka analizuar edhe dosjen e kandidatës së shpallur fituese A.Z, ku dhe ka konstatuar se e njëjta posedon Diplomën me Nr.3647, të datës 06.01.2022, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për përfundimin e studimeve themelore më datë 24.12.2021, në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, duke marrë titullin Bachelor i Ekologjisë dhe Mbrojtjes së Ambientit; si dhe Diplomën Nr.1210, të datës 19.09.2024, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për përfundimin e studimeve master në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, duke marrë titullin Master i Shkencave të Biologjisë. Ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit kandidatja ka bashkangjitur: Referencën e datës 14.01.2022, të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, më të cilën dëshmohet se ka qenë në pune praktike në këtë institucion në periudhën kohore 14.12.2021 deri me 14.01.2022 (1 muaj); referencën e datës 27.05.2022, të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, më të cilën konfirmohet se kandidatja ka qenë në punë praktike nga data 14.03.2022 deri 02.10.2022 (7 muaj e 18 ditë); Marrëveshjen për punë praktike më MMPHI-së për periudhën 03.04.2023 deri 02.10.2023 (6 muaj) praktike e vazhduar edhe për periudhën 03.10.2023 deri më 02.04.2024, si dhe Akt emërimin me numër Nr.13-111/01-0050201/2024, për emërim në pozitën e punës *Zyrtare për Mbrojtjen e Mjedisit* në Komunën e Podujevës, punë të cilën e ushtron data 01.08.2024.(kandidatja posedon edhe përvojë tjetër të punës mirëpo Kolegji vlerësoj si jo relevante pasi që përvoja e punës e lartshënuar plotësojnë kriterin e përvojës së punës pas diplomimit).

Andaj, si pasojë e analizimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatës fituese, rrjedhë se e njëjta i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se kandidatja A.Z ka arritur numrin më të madh të pikëve në procedurë të vlerësimit, atëherë, më të drejtë, njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shpallur si kandidate fituese për procedurën me numër reference RN00016376, duke vepruar në pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se procedura me numër reference RN00016376, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1043/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, E.R-H;
- Udhëheqësit të Personelit në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.